

Vendim nr. 214 datë 30.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “ERTA” SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokatët Neritan Cena dhe Admir Thanza, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-43, datë 16.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 15, 17, 18, 41, 42, 43, 44, 57, pika 7, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të saj; nenet 27, 71, pika 1, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Erta” sh.p.k., me seli në Tiranë, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit tregtar, kurse specializimi dhe kualifikimi afatshkurtër e afatgjatë në fusha të ndryshme në Universitetin Jopublik “Illyria”, si dhe kurse të formimit dhe të kualifikimit për gjuhë të huaja, programe kompjuterike, teknike, informatike, shkolla parauniversitare të përgjithshme dhe profesionale në profilet sipas kërkesave të kohës etj.

2. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 1360, datë 10.10.2008, ka vendosur licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Illyria” dhe me urdhrin nr. 286, datë 03.09.2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është lejuar ushtrimi i veprimtarisë akademike “Illyria”, konform licencës së dhënë asaj. Ndërkohë, me vendimin nr. 393, datë 19.5.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë institucionit privat të arsimit të lartë “Illyria”, Tiranë”, Këshilli i Ministrave vendosi “hapjen në shkollën e lartë private “Illyria”, Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë. “Illyria”, gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj arsimor, rezulton të ketë kryer disa riorganizime të tij.

3. Në vijim, me urdhrin nr. 106, datë 28.03.2014 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kryerjen e kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në institucionet publike dhe jopublike të Arsimit të Lartë”(urdhri nr.106/2014), është ngritur nëngrupi i punës për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, i miratuar me urdhrin nr. 186, datë 13.05.2014 “Për ngritjen e nëngrupit të punës, në zbatim të urdhrit nr. 106, datë 28.03.2014” të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Pas përfundimit të kontrollit, në datën 23.05.2014, është hartuar projektraporti i parë, i grupit të kontrollit, ku janë evidentuar parregullsi dhe mospërmbushje standardesh. Në datën 16.06.2014 raporti i është dërguar institucionit “Illyria”, për të paraqitur observacionet e saj.

4. Pasi ka marrë në konsideratë observacionet e dërguara nga “Illyria” MAS-i ka hartuar raportin përfundimtar të ekipit monitorues, të protokolluar në MAS në datën 01.08.2014, i cili ka shërbyer më pas në përgatitjen e projektvendimit të Këshillit të Ministrave dhe relacionit shoqërues për heqjen e licencës së disa institucioneve private të arsimit të lartë ku bënte pjesë edhe “Illyria”, dërguar Këshillit të Ministrave në datën 05.08.2014. Propozimi i MAS-it në Këshillin e Ministrave për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë është bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr.9741/2007), i

cili parashikon se për institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk respektojnë këtë ligj, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit, vendos masa konkrete deri në pezullimin e veprimtarisë së tyre për një periudhë deri në 2 vjet (mospranim të studentëve të rinj), ose heqjen e licencës.

5. Për propozimin e MAS-it, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 539, datë 06.08.2014 “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë” (VKM-ja nr.539/2014), ka vendosur: (i) në pikën I heqjen e licencës për disa institucione private të arsimit të lartë, për të gjitha njësitë e tyre përbërëse (njësi kryesore, bazë dhe ndihmëse) dhe ndërprerjen e veprimtarisë së tyre në vitin akademik në vijim; (ii) në pikën II përcaktohen institucionet private të arsimit të lartë që u hiqet licenca; (iii) ndërsa në pikën II/14 është përcaktuar se institucionit “Illyria”, e themeluar nga shoqëria “Erta” sh.p.k., i hiqet licenca.

6. Pas botimit të VKM-së nr.539/2014 në Fletoren Zyrtare të datës 07.08.2014, kërkuesja ka paraqitur ankim administrativ në datën 25.08.2014 pranë Këshillit të Ministrave, për të cilën nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje.

7. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi, me objekt: (i) shfuqizimin për shkak të pavlefshmërisë së VKM-së nr.539/2014 në pikat 11 dhe 14; (ii) si dhe rivendosjen e gjendjes ligjore të mëparshme, duke e lejuar kërkuesen të vazhdojë ushtrimin e aktivitetit. Palë e paditur është thirrur Këshilli i Ministrave dhe person i tretë, MAS-i.

8. Me vendimin nr. 495, datë 06.02.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se VKM-ja nr.539/2014 është në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit nr. 9741/2007, të ndryshuar. Kundër këtij vendimi, në datën 09.02.2015, ka paraqitur ankim (zënie afati) kërkuesja, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar se nuk është dakord me dispozitivin e vendimit, pasi arsyetimi nuk i është komunikuar dhe u qëndron pretendimeve të ngritura në padi. Në datën 04.10.2017 kërkuesja ka depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit parashtrimet dhe objeksionet në mbështetje të ankimit të saj.

9. Me vendimin nr. 4214 (86-2017-4457), datë 12.10.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë me atë për sa i përket natyrës së aktit administrativ objekt shqyrtimi, procedurës së nxjerrjes së tij dhe pavlefshmërisë. Kundër këtij vendimi, në datën 13.12.2017, ka paraqitur rekurs kërkuesja, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

10. Me vendimin nr. 00-2025-43, datë 16.01.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*).

11. Në datën 05.06.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 13.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuases

12. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

12.1. 1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të rëndësishme të ngritura në gjykim nga kërkuësja si: (i) kontrolli nuk është kryer nga Inspektorati Shtetëror, si organi shtetëror i ngarkuar nga ligji, por nga MAS-I, duke e bërë urdhrin nr. 106, datë 28.03.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it absolutisht të pavlefshëm; (ii) nuk është marrë në analizë mospërputhja e datave për nxjerrjen e raportit përfundimtar të kontrollit dhe të propozimit të MAS-it për heqjen e licencës, duke passjellë që VKM-ja nr.539/2014 të jetë absolutisht e pavlefshme.

12.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi kërkuësja nuk ka mundur të paraqesë shkaqet e ankimit të saj për shkak se nuk i është komunikuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që u është komunikuar palëve të tjera në proces. Administratat gjyqësore të gjykatave të faktit duhet të njoftonin kërkuësen për vendimin e arsyetuar objekt ankimi, si dhe për plotësimin e kërkesave të ankimit, ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka treguar se në mungesë të një ankimi pa shkaqe nuk e ka dëgjuar kërkuësen.

12.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi kërkuesja është përballur me procedura joligjore të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarisë së saj nga organet administrative, duke u hapur rrugën abuzimeve, mbivendosjes së kompetencave dhe arbitraritetit të organeve administrative shtetërore, situatë kjo e paanalizuar nga gjykatat më të ulëta, si dhe nga Kolegji Administrativ.

12.3. *E drejta e pronës private*, si rezultat i cenimit të procesit të rregullt ligjor.

12.4. *Liria e veprimtarisë ekonomike*, e garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet me natyrë kushtetuese për procedurën administrative të ndjekur në kundërshtim me ligjin, e cila ka passjellë heqjen e licencës për të ushtruar veprimtari ekonomike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur, për rrjedhojë është bartëse e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

15. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr.*

33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar, ndër të tjera, se i është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit*, pasi ajo nuk ka mundur të paraqesë shkaqet e ankimit të saj për shkak se nuk i është komunikuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që u është komunikuar palëve të tjera në proces, si dhe administratat gjyqësore të gjykatave të faktit duhet të njoftonin kërkesuesen për vendimin e arsyetuar objekt ankimi, si dhe për plotësimin e kërkesave të ankimit, ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka treguar se, në mungesë të një ankimi pa shkaqe, nuk e ka dëgjuar kërkesuesen. Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se në datën 04.10.2017 kërkesja ka depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit parashtrime dhe objeksione, në mbështetje të ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë nuk e ka ngritur këtë pretendim në rekursin në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë, për këtë pretendim, ajo nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

17. Lidhur me pretendimet e tjera, Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr.8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 16.01.2025, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 05.06.2025, në dukje jashtë afatit ligjor 4-mujor. Nga komunikimi shkresor i datës 18.04.2025 Gjykata e Lartë ka vënë në dijeni kërkuesen se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 10.02.2025, datë në të cilën ai është bërë i disponueshëm për palët. Për sa më lart, rezulton se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm në datën 10.02.2025, e cila është edhe data nga e cila fillon të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, si dhe të parimit të sigurisë juridike, së drejtës së pronës private dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronës private dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkueses lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, Kolegji çmon t'i analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, sipas të cilit gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm nuk kanë analizuar e arsyetuar për paligjshmërinë e procedurave të kontrollit e të inspektimit të veprimtarisë së saj, Kolegji çmon ta analizojë në këndvështrim të drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

21. Kërkuesja ka pretenduar se gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar si dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të rëndësishme të ngritura në gjykim nga kërkuesja, duke nisur me kontrollin e kryer nga MAS-i dhe jo nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), si organi shtetëror i ngarkuar nga ligji, duke e bërë absolutisht të pavlefshëm urdhrin nr. 106, datë 28.03.2014 të MAS-it. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar mospërputhjen e datave për nxjerrjen e Relacionit mbi Monitorimin e “Illyria”, i cili daton në datën 12.08.2014, ndërkohë

që propozimi i ministrit të Arsimit për heqjen e licencës daton më 05.08.2014, duke passjellë që VKM-ja nr.539/2014 të jetë akt i pavlefshëm, për shkak të mosrespektimit të procedurës së parashikuar nga ligji.

22. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës, parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin në shqyrtim, procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga kërkesja, e cila ka ngritur një padi, me objekt: (i) shfuqizimin për shkak të pavlefshmërisë së VKM-së nr.539/2014 në pikat 11 dhe 14; (ii) si dhe rivendosjen e gjendjes ligjore të mëparshme, duke e lejuar kërkesen të vazhdojë në ushtrimin e aktivitetit. Gjykata Administrative e Shkallës

së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM-së nr.539/2014, nxjerrë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit nr. 9741/2007, të ndryshuar, ka ndërmarrë masën drastike të heqjes së licencës për shkak të shkeljeve ligjore dhe nënligjore të institucionit “Illyria”. Sipas gjykatës së shkallës së parë, MAS-i, si institucion përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve në institucionet publike e private të arsimit të lartë, ka të drejtën dhe detyrimin të kryejë kontrolle periodike sipas nenit 64, pika 1, të ligjit nr. 9741/2007, të ndryshuar, si dhe ISHA-ja, sipas VKM-së nr.352, datë 03.04.2013, është institucion në varësi të MAS-it, për rrjedhojë urdhri nr.106/2014 i ministrit të Arsimit dhe Sportit është i ligjshëm dhe brenda kompetencave ligjore. Po kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë, VKM-ja nr.539/2014 ka rezultuar një akt administrativ, i cili ka përmbushur kriterin e arsytimit, si dhe kërkueses i janë bërë të njohura përfundimet e raportit të monitorimit dhe i është dhënë mundësia të paraqesë observacionet përkatëse. Ndërkohë në lidhje me bazueshmërinë në themel, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se të gjitha shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit të MAS-it, përbëjnë cenim të ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë me atë, për sa i përket natyrës së aktit administrativ objekt shqyrtimi, procedurës së nxjerrjes së tij dhe pavlefshmërisë absolute dhe relative të VKM-së nr.539/2014.

25. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, si dhe ajo nuk ka parashtruar asnjë argument të qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet për të cilat të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është rasti as për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

26. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuësja ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në të tria shkallët e gjykimit, duke iu garantuar asaj e drejta për të paraqitur pretendime në gjykim, sikundër edhe për të paraqitur ankim në gjykatat më të larta, duke marrë përgjigje nga ato. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në vendimet e tyre kanë paraqitur rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat janë bazuar për zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i gjykatave se urdhri nr.106/2014 i MAS-it dhe VKM-ja nr. 539/2014 nuk janë akte absolutisht të pavlefshme, por akte administrative brenda kompetencave ligjore të institucioneve përkatëse, nuk rezulton të jetë arbitrar në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Edhe për sa i përket pretendimit tjetër për mosshqyrtimin nga gjykata të pretendimit për

mospërputhje të datave për nxjerrjen e Relacionit mbi Monitorimin e institucionit “Illyria” dhe të propozimit të ministrit të Arsimit për heqjen e licencës, të cilat, sipas kërkuases, passjellin pavlefshmëri të VKM-së nr.539/2014, për shkak të mosrespektimit të procedurës së parashikuar nga ligji, edhe pse jo i trajtuar në mënyrë specifike, Kolegji vlerëson se gjykatat i kanë kthyer përgjigje gjatë trajtimit të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, pasi detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë, ndaj kërkuases i është garantuar e drejta e aksesit.

27. Po kështu, për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, ai përmban të dhënat e palëve, rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, si dhe shkaqet e rekursit. Për më tepër, Kolegji çmon se pretendimet në rekurs janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe me interpretimin e ligjit procedural dhe material.

28. Në përfundim, Kolegji vlerëson se në procesin gjyqësor të kundërshtuar kërkuases i është garantuar e drejta e aksesit dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përmbushur standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, ndaj, për rrjedhojë, pretendimi i saj në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

29. Për sa më lart, në kushtet kur pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor, të ngritur nga kërkuësja në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike, të ndërvarura nga procesi, janë haptazi të pabazuara.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.